

në qershor të vitit 1999, mbetjet mortore të tij janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Oshlan/Ošljane. Më 22.08.2000, ekspertët ndërkombëtar për mjekësinë ligjore i kanë zhvarrosur mbetjet mortore të Sheremetit dhe pas verifikimit të identitetit, familjarët e rivarrosën në varrezat e njëjta.

Mustafa u varros më 26.09.1998, në varrezat në Oshlan/Ošljane. Saktësisht një vit më vonë, mbetjet mortore të tij janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës.

Burimet: deklarata N.S, FDH-19402; deklarata J.S, FDH-30724; J. Martinsen, Regjistri., FDH-26092; FHP, *Që njerëzit ti mbajnë në mend njerëz*, pyetësor, FDH-29763.

Musa (Shaban) Sheremeti

(1939, shqiptar nga Oshlani/Ošljane, komuna e Vushtrrisë/Vučitrn, bujk, gjashtë fëmijë)

Musa dhe bashkëshortja e tij Sherifja, më 20.09.1998, e kishin dërguar vëllain e sëmurë të Musës në Shipol/Šipolje [Mitrovicë/Kosovska Mitrovica]. Dy ditë pas kthimit të tyre [22.09.1998], forcat serbe kishin hyrë në fshat [Oshlan/Ošljane]. Banorët e fshatit kishin nisur të ikin në pyll. Djemtë e Musës, Nuredini dhe Shemsedini, kishin ikur në njerën anë të pyllit, ndërsa ai dhe Sherifja, në anën tjetër të pyllit. Në rrëmujën e krijuar, Musa ishte ndarë nga bashkëshortja dhe nga ai çast për fatin e tij asgjë nuk dihej. Pas tërheqjes së forcave serbe nga fshati, më 25.09.1998, pjesëtarët e UÇK-së i kishin gjetur mbetjet mortore të Musës në stallën e djegur të një bashkëfshatari, Abdullah Shyti. Atë e varrosën në varrezat e fshatit. Pas luftime, në qershor të vitit 1999, familjarët i varrosën mbetjet mortore në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës. Në datën 22.08.1999, patologët ndërkombëtar i kanë zhvarrosur mbetjet mortore të Musës dhe i bartën në Institutin për Mjekësinë Ligjore në Rahovec/Orahovac, me qëllim të konstatimit të shkakut të vdekjes. Në shtator të vitit 2000, familjarët i rivarrosën mbetjet mortore të Musës në të njëjtin vend.

Burimet: deklarata N.Sh, FDH-19575; deklarata N.S, FDH-19402; KMDLNJ, *Buletini*,

num. 9, october-december 1998, 116, FDH-23857.

Halit (Sadik) Hyseni

(10.07.1955, shqiptar nga Oshlani/Ošljane, komuna e Vushtrrisë/Vučitrn, punëtor në ndërmarrjen Polet në Vushtrri/Vučitrn, dy fëmijë)

Seladin (Sadik) Hyseni

(20.02.1970, shqiptar nga Oshlani/Ošljane, komuna e Vushtrrisë/Vučitrn, i papunë, një fëmijë)

Familja Hyseni e kishte braktisur Oshlanin/Ošljane më 21.09.1998, pasi që dëgjuan se forcat serbe po i afroreshin fshatit. Në shtëpi kishte mbetur vetëm Seladini. Po atë ditë u kthye edhe Haliti, vëllai i Seladinit, ngase nuk dëshironte që të vëllain ta linte vetëm. Të nesërmen, më 22.09.1998, kur forcat serbe kishin hyrë në fshat, Seladini dhe Haliti, së bashku me Naimin dhe Naserin dhe bashkëfshatarët e tjerë, ikën në pyllin e afërt [Oshlan/Ošljane]. Përafërsisht rreth 500 metra larg nga pylli, u ndeshën me pjesëtarët e forcave serbe, të cilët kishin filluar të shtënin ndaj tyre. Haliti dhe Seladini u vranë në vend, derisa të tjerët arritën që të ikin me vrap. Familjarët për fatin e Seladinit dhe Halitit kanë mësuar më 27.09.1998, nga një kushëri të tyre, Bajram Hyseni. Ai u kishte treguar se mbetjet mortore të Seladinit dhe Halitit i kishte gjetur në pyll më 25.09.1998, pas tërheqjes së forcave serbe. Të nesërmen, i kishte varrosur së bashku me pjesëtarët e UÇK-së, në varrezat e fshatit. Në qershor të vitit 1999, familjarët i kishin rivarrosur mbetjet e tyre mortore në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Oshlan/Ošljane. Për shkak të zhvarrosjes dhe ekspertizës, ata u rivarrosën më 27.09.2000.

Burimet: deklarata E.H, FDH-19398; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, october-december 1998, 122, FDH-23857; FHP, *Që njerëzit ti mbajnë në mend njerëz*, pyetësor, FDH-29763.

Ahmet (Januz) Krasniqi

(1921, shqiptar nga Zhilivoda/Žilivoda, komuna e Vushtrrisë/Vučitrn, pensionist, shtatë fëmijë)

Para pensionimit, Ahmeti kishte punuar